 Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al	Të drejtat dhe obligimet e organizmave të vlerësimit të konformitetit të akredituar	Kodi DA-PM-011
		Rishikim nr 3 Dt: 20.05.2019
		Faqe 1 nga 4


Të drejtat dhe obligimet e organizmave të vlerësimit të konformitetit të akredituar

**Zbatues: Organizmat e akredituar, organizmat që kanë aplikuar për akreditim,
Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit**

Përgjegjës për zbatimin: Menaxheri i cilësisë

Kontrolloi: Menaxheri i cilësisë
MELE

Miratoi: Drejtori i Përgjithshëm Ardita
Armond HALEBI

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Të drejtat dhe obligimet e organizmave të vlerësimit të konformitetit të akredituar	Kodi DA-PM-011
		Rishikim nr 3 Dt: 20.05.2019
		Faqe 2 nga 4

1 QËLLIMI

Kjo procedurë përshkruan të drejtat dhe detyrimet që kanë organizmat e vlerësimit të konformitetit pas marrjes së statusit të akreditimit, ose që kanë aplikuar për akreditim.

2. FUSHA E ZBATIMIT

Kjo procedurë zbatohet nga OVK e akredituara për sa kohë që ato gëzon statusin e akreditimit dhe nga OVK që kanë aplikuar për akreditim. Procedura zbatohet si nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të fushës së detyrueshmë ashtu edhe asaj vullnetare.

3. PËRGJEGJËSITË

Kjo procedurë zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit. Përgjegjës për zbatimin e kësaj procedure është menaxheri i cilësisë.

4. REFERIMET

Standardi ISO/IEC 17011:2017 “Kërkesa për organizmat e akreditimit të cilat akreditojnë organet e vlerësimit të konformitetit” paragrafi 8.2.

Ligji nr. 116 datë 11.09.2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Manuali i Cilësisë DA-MC-001

5. FJALORI DHE SHKURTIME


Për qëllimet e kësaj procedure janë përdorur termat dhe përkufizimet e dhëna në standardin ISO/IEC 17011:2017 dhe në shtojcën e Manualit të Cilësisë DA-MC-001.

6. PËRSHKRIMI I PROCEDURËS

6.1 Të drejtat e organizmit të vlerësimit të konformitetit.

Organizmi duhet të:

1. plotësojë kërkesat e serisë së standardeve S SH ISO 17000 për të gjithë fushën e akreditimit dhe të adaptojë të gjitha ndryshimet në kërkesat e standardeve.
2. deklaroj statusin e tij të akreditimit duke respektuar fushën e akreditimit.;
3. mos përdor akreditimin në mënyrë të tillë që të prish reputacionin dhe emrin e Drejtorisë së Përgjithshme e Akreditimit si dhe nuk duhet të bëjë ndonjë deklaratë që mund të krijojë shqetësime dhe keqinterpretime për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit.
4. ndjekë kërkesat e përcaktuara në politikën DA-P0-005 “Për përdorimin e simbolit të akreditimit” kur i referohet akreditimit.


 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Të drejtat dhe obligimet e organizmave të vlerësimit të konformitetit të akredituar	Kodi DA-PM-011
		Rishikim nr 3 Dt: 20.05.2019
		Faqe 3 nga 4

5. ndërpresë përdorimin e simbolit të akreditimit apo të kthejë certifikatën e akreditimit në rastet kur pezullohet apo tërhiqet akreditimi
6. paguajë tarifat sic është përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
7. informojë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme e Akreditimit kur ndodhin ndryshime të rëndësishme që mund të ndikojnë në plotësimin e kërkesave për akreditim. Ndryshime të tilla janë:
 - në statusin e tij ligjor, pronësia ose statusi organizativ;
 - organizimi, personeli teknik dhe menaxherial.
 - Politikat dhe procedurat kryesore;
 - Burimet (pajisje) dhe vendndodhja ;
 - Fusha e akreditimit dhe të tjera çështje të cilat mund të ndikojnë aftësinë ose fushën e akreditimit;
8. marrë pjesë në testet e zotësisë sic kërkohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe të informojë Drejtorinë mbi rezultatet e testeve të tilla.
9. bashkëpunonjë me përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit për të bere të mundur vlerësimin e plotësimit të kërkesave të akreditimit. Organizmi duhet :
 - t'i japë akses përfaqësuesve të DPA në personelin, vendndodhjet, pajisjet, informacionin, dokumentacionin dhe rregjistrimet (duke përfshirë rregjistrimet e auditimeve të brendshme, rezultatet e testeve të zotësisë);
 - të marrë masa për organizimin e vlerësimeve me dëshmi;
 - të japë akses tek dokumentacioni për të vlerësuar paanëshmërinë dhe pavarësinë e tij nga organizmat e tjerë.
 - Nëse kërkohet nga DPA, të realizohet vlerësimi i performancës së OVK kur kryen aktivitete të vlerësimit të konformitetit në ambientet e klientëve;
10. pajtohet me kushtet e parashikuara në kontratën e nënshkruar me DPA.

6.2 Të drejtat e organizmit të vlerësimit të konformitetit

Organi i vlerësimit të konformitetit ka të drejtë t'i kërkoj Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të plotësoj detyrimet e mëposhtme:

1. DPA funksionon në përputhje me Ligjin nr. 116 datë 11.09.2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, kërkesat e standardeve të serisë S SH ISO 17000, rekomandimet e DPA, rekomandimet dhe udhëzimet e EA, ILAC dhe IAF si dhe procedurave të DPA.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton organe mbi bazën e aplikimit të tij dhe kushteve të vendosura në kontratën e nënshkruar midis organizmit dhe DPA.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit njofton organin për cdo ndryshim në kërkesat e standardeve apo procedurave të saj të paktën një muaj me parë.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Të drejtat dhe obligimet e organizmave të vlerësimit të konformitetit të akredituar	Kodi DA-PM-011
		Rishikim nr 3 Dt: 20.05.2019
		Faqe 4 nga 4

4. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit publikon listën e organeve të akredituar duke treguar emrat e tyre, adresat dhe fushën e tyre të akreditimit.
5. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit pajtohet me kushtet e parashikuara në kontratën e nënshkruar midis dy palëve.
6. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon OVK duke u bazuar në politikat e saj, për mënyrat më të përshtatshme për sigurimin e gjurmueshmërisë së rezultateve të matjeve.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon OVK, mbi bazën e kërkesës së tyre, statusin e anëtarësimit të DPA në organizmat ndërkombetare të akreditimit apo të marrëveshjeve të cilat DPA ka nënshkruar me organizmat e huaj të akreditimit.
8. Të asistojë në investigimin dhe zgjidhjen e ankesave në lidhje me aktivitetin e akredituar të OVK

7. HISTORIKU

Data e Ripunimit	Numri i Ripunimit	Autori	Përshkrimi i ndryshimeve të bëra
30.10.2006	0	A. Cuni	Varianti fillestar
28.04.2009	1	A Fuga	Pasqyrimi i pikës 8.2.2 dhe 8.2.3 të ISO 17011. Ndryshime dhe në përgjegjësitë e OVK që kanë aplikuar për akreditim në lidhje me pjesëmarrjen në PT, zbatimin e kontratës gjatë procedurës së akreditimit, pagesa e tarifave, kryerja e testeve me deshmi, etj.
22.12.2014	2	E. Fyshku	Ndryshime në header, në pikën 4 ``Referencat`` si dhe në pikën 6.2 lidhur me legjislacionin e ri për akreditimin.
20.05.2019	3	A. Mele	Ndryshime në pikat 4, 5 dhe 6.1 dhe 6.2